



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:200898
Datë: 01.11.2024
Numri i dokumentit: 06383514

Pml.nr.594/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit I. Z., nga fshati ..., komuna e M., për shkak të veprës penale “Vrasja”, nga neni 172 të Kodit Penal të Republikës të Kosovës (KPRK) dhe veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.8/2024, të datës 11.03.2024 dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.254/2024, të datës 06.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 15.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit I.Z., e paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, PKR.nr.8/2024, të datës 11.03.2024 dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.254/2024, të datës 06.06.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.8/2024, të datës 11.03.2024, i dënuari I. Z., është shpallur fajtor për shkak të veprës

penale “Vrasja”, nga neni 172 të KPRK-së (pika I. e dispozitivit) dhe veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së (pika II. e dispozitivit), ashtu që ndaj të njëjtit, për shkak të veprës penale sipas pikës I. të dispozitivit është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej shtatëmbëdhjetë (17) vjetëve, kurse për shkak të veprës penale sipas pikës II. të dispozitivit është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) vjet e gjashtë (6) muajve.

Duke u bazuar në nenin 76, paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2, nën-paragrafi 2.2. të KPRK-së, ndaj të dënuarit I. Z., është shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej nëntëmbëdhjetë (19) vjetëve, në të cilin dënim, në bazë të nenit 79 të KPRK-së, do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 20.09.2023 e tutje.

Ndaj të dënuarit I. Z., është konfiskuar arma e tipit “SIG SAUER-P320”, me numër serik 58H075982; pesëdhjeteshtatë (57) fishekë të kalibrit 9x19 mm në dy (2) pako dhe një (1) karikator me shtatë (7) fishekë të kalibrit 9x19 mm, sipas listës së armëve të sekuestruara, me numër të rastit ..., si objekt i kryerjes së veprës penale, ndërsa pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, arma e konfiskuar do të shkatërrohet, në rast se nuk evidentohet se e njëjta është përdorur në ndonjë rast tjetër të hapur nga Libri i Rasteve të Hapura, të cilën e ka pasur në posedim i dënuari në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.2. të Ligjit nr.05/L-022 për Armë.

Është detyruar i dënuari I. Z., që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej pesëdhjetë (50) euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej pesëdhjetë (50) euro, të gjitha këto në afat prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Të dëmtuarit: M. G.-B., E. B., O. B. dhe A. B., të gjithë nga fshati ..., komuna e S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest të rregullt juridiko-civil.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin e PAKR.nr.254/2024, e datës 12.04.2024, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, të përfaqësuesit të palës së dëmtuar – M. G. – B., avokatit Blerim Mazreku dhe të mbrojtësit të të dënuarit, avokatit A. H., ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit, avokati Asman Hoxha, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve procedurale dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e aktgjykimit, duke propozuar Gjykata Supreme e Kosovës t'i anulojë aktgjykimet e kundërshtuara, ashtu që çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, apo që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen, ashtu që ndaj të dënuarit të shqiptohet dënim më i butë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresat KMLP.II.nr.203/2024, e datës 02.10.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), si dhe pasi i vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe përgjigjen në kërkesë të Kryeprokurorit të Shtetit, gjeti se:

- kërkesa është e pabazuar.

Nga tërë përmbajtja e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, del që mbrojtësi i të dënuarit pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkeljet e lartcekura, në radhë të parë për faktin se i dënuari ka poseduar leje për posedimin e armës, kështu që nuk është dashur që i njëjti të shpallet fajtor sa i përket veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së. Andaj, edhe në këtë pjesë, aktgjykimet e kundërshtuara janë konfuzë dhe të paqartë dhe nuk përfshijnë arsyet e duhura në lidhje me veprën penale dhe përgjegjësinë penale të të dënuarit.

Kurse, sa i përket veprës penale “Vrasja”, nga neni 172 të KPRK-së, mbrojtësi i të dënuarit pretendon se gjykatat kanë shqiptuar një dënim të rëndë, duke e pasur parasysh faktin se kanë ekzistuar 8-9 rrethana lehtësuese, të cilat si të tilla dhe së bashku, kanë justifikuar edhe aplikimin e neneve 71 dhe 72 të KPRK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shikimit të shkresave të lëndës konstatoi se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar, për faktin se aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë nuk janë të përfshira me ndonjë shkelje të esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe as me shkelje të ligjit penal në dëm të të dënuarit I. Z.

Në pikën II. të dispozitivit të aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme është paraqitur vepra penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari I. Z., së bashku me të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme që e përbëjnë figurën e veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal, ashtu siç parashihet në nenin 369, paragrafi 4 lidhur me nenin 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së.

Në anën tjetër, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjyimit të saj rezulton se ka paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha çështjet e rëndësishme, përkatësisht për të gjitha pikat e aktgjyimit, duke përfshirë këtu edhe paraqitjen e arsyeve sa i përket vendimit për miratimin e pranimit të fajësisë nga ana e të dënuarit I. Z., përkitazi me veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366,

paragrafi 1 të KPRK-së, ku me atë rast kishte vlerësuar se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë, të parashikuara në nenin 242 të KPP-së.

Në këtë drejtim, pas shikimit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundimin se në këtë rast janë respektuar dispozitat përkatëse ligjore që i referohen pranimit të fajësisë në kuptim të neneve 241 - 242 të KPP-së, si në kuptim të përmbushjes së kushteve ligjore për miratimin e pranimit të fajësisë, ashtu edhe në kuptim të respektimit të procedurës, si para, ashtu edhe pas marrjes së aktvendimit për miratimin e pranimit të fajësisë, ndërsa edhe vetë mbrojtësi i të dënuarit kishte propozuar që të miratohet pranimi i fajësisë dhe nuk kishte pasur asnjë vërejtje në këtë drejtim.

Përtej këtij aspekti, nga shkresat e lëndës, nuk rezulton që i dënuari I. Z., të ketë poseduar “Leje për lëvizje me armë”, ashtu siç parashihet në nenin 2, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6. i Ligjit nr.05/L-022 për Armë të datës 23.07.2015. Përndryshe, “Leja për lëvizje me armë” është një leje e posaçme që mund t’i lëshohet personit juridik dhe personit fizik për të lëvizur me armë nga një vend në një vend tjetër, ndërsa personi nuk ka të drejtë që ta bartë armën nga një vend në një vend tjetër pa posedimin e një leje të tillë, të cilën e lëshon organi kompetent, kurse mos posedimi i kësaj “Leje për lëvizje me armë” ngërthen në vete aspekte juridike penale, nëse personi lëviz me armë nga një vend në një vend tjetër, pavarësisht faktit që personi posedon “Leje për mbajtjen e armës”. Sipas dispozitës së lartcekur ligjore, “Leja për lëvizje me armë” është një dokument që i lëshohet personit juridik dhe personit fizik nga organi kompetent i përcaktuar me Ligjin për Armë, me të cilin personit juridik i njihet e drejta e lëvizjes nga depoja në vendin për gjah, shenjëtari ose në vendin për riparim dhe transport për armët e koleksionit të lejuara ose për ekspozitë, kurse për personin fizik, me leje të lëshuara për armë i njihet e drejta për lëvizjen nga vendbanimi i personit fizik në vendin për gjah ose shenjëtari ose në vendin për riparim dhe transport të armëve të koleksionit për ekspozitë.

Duke qenë se dispozita ligjore e nenit 366, paragrafi 1 të KPRK-së, me të cilën është parashikuar forma themelore e veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” është e karakterit “blanket”, ngase udhëzon në aplikimin e Ligjit të lartcekur për Armë, rezulton se një vepër e tillë penale konsiderohet se është kryer edhe në rastet personi lëviz me armë në mënyrën e përcaktuar më lart, pa poseduar “Leje për lëvizje me armë”, pavarësisht faktit se i njëjti ka poseduar “Leje për mbajtjen e armës”, kështu që edhe pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit nuk qëndrojnë.

Sa i përket çështjes së shqiptimit të dënimeve më të buta, Gjykata Supreme e Kosovës rikujton se sipas dispozitës së nenit 385, paragrafi 5 të KPP-së, kur është fjala për vendimin për dënimin, shkelje e ligjit penal konsiderohen vetëm rastet kur në marrjen e vendimit për dënimin, gjykata ka tejkalluar kompetencat ligjore. Pra, me fjalë të tjera, sipas kësaj dispozite ligjore, tejkallimi i kompetencave ligjore nga ana e gjykatës me rastin e vendosjes lidhur me dënimin, konsiderohet si shkelje e ligjit penal. Ndërsa, në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar rrethanat përkatëse relevante, të dënuarit I. Z. i ka shqiptuar dënimet përkatëse me burgim, ndërsa më pastaj edhe dënimin unik me burgim, brenda

kufijve të parashikuara me ligj për veprat penale për të cilat i njëjti është shpallur fajtor, çka do të thotë se nuk janë tejkaluara kompetencat ligjore.

Përndryshe, edhe në këtë çështje penale, Gjykata Supreme e Kosovës rithekson se matja e dënimeve dhe vlerësimi i rrethanave përkatëse relevante është në kompetencë të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, varësisht nga rrethanat e rastit, ndërsa duke u bazuar në nenin 432, paragrafi 1 të KPP-së, këto pretendime në lidhje me shqiptimin e dënimeve më të buta, nuk mund të jetë arsye për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Përveç kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës sqaron se zbatimi i dispozitave ligjore të zbutjes së dënimit nga nenet 71 dhe 72 të KPRK-së, është vetëm një mundësi fakultative dhe se mbetet nën autoritetin e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë, që të vlerësojnë nëse këto dispozita ligjore duhet zbatuar apo jo, gjithnjë duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat që i përkasin si veprës penale, ashtu edhe kryesit saj, por jo vetëm.

Andaj, edhe nga arsyet e cekura më lart, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar dhe pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.594/2024, më datë 15.10.2024

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Mejreme Memaj